



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 168

27 dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 131/2012 datë 27.12.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar..... 9379
Dekret nr. 7896 datë 27.12.2012	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 9387
Vendim i KM nr. 854, datë 4.12.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Dërmenas të qarkut të Fierit..... 9387
Vendim i KM nr. 855, datë 4.12.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Allkaj të qarkut të Fierit..... 9389
Vendim i KM nr. 856, datë 4.12.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shalë të qarkut të Shkodrës..... 9390
Vendim i KM nr. 857, datë 4.12.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Mesopotam të qarkut të Vlorës..... 9391
Vendim i KM nr. 858, datë 4.12.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 903, datë 21.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi apo në përdorim të komunës Trebisht të qarkut të Dibrës”..... 9392

Vendim i KM nr. 859, datë 4.12.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 299, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Stravaj të qarkut të Elbasanit” dhe miratimin e listës së pronave të tipit pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të kësaj komune.....	9392
Vendim i KM nr. 860, datë 4.12.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 916, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Vërtop të qarkut të Beratit” dhe për një ndryshim në vendimin nr. 417, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Vërtop të qarkut të Beratit”.....	9393
Vendim i KM nr. 861, datë 4.12.2012	Për lejimin e Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes, si autoritet kontraktor, për lidhje kontrate shtesë rikonstruksioni.....	9394
Vendim i KM nr. 865, datë 4.12.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 535, datë 7.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2012-2013”.....	9395
Vendim i KM nr. 866, datë 4.12.2012	Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre.....	9395
Vendim i KM nr. 925, datë 19.12.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, për përballimin e detyrimeve kontraktore ndaj “Univers-Alb” sh.a.....	9405
Vendim i BSH nr. 67, datë 27.11.2012	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.....	9405
Vendim i KKRT nr. 157, datë 30.11.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radifonik privat me përsëritës “Radio World Family”.....	9406
Vendim i KKRT nr. 158, datë 30.11.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radifonik privat vendor “Radio Ime”.....	9406
Vendim i KKRT nr. 159, datë 30.11.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radifonik privat vendor “Radio Klan”.....	9407

LIGJ
Nr. 131/2012

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9643, DATË 20.11.2006 “PËR
PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 84 pika 4 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pika 20 riformulohet si më poshtë:

“20. “Kërkesë për propozim” është procedura, me anë të së cilës autoriteti kontraktor kërkon oferta nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë të përzgjedhur prej tij, por pranon edhe oferta të paraqitura nga operatorë të tjerë ekonomikë, të interesuar.”.

Neni 2

Në nenin 4, fjalët “dhe ato që rregullohen me ligj tjetër” hiqen.

Neni 3

Titulli i nenit 6 ndryshohet si më poshtë:

“Kontratat sekrete, kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”.

Neni 4

Në nenin 12 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “që i janë vënë në dispozicion” hiqen.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

Direktivën 2004/18/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 31 mars 2004 “Mbi koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shpërblime”, Numri CELEX: 32004L0018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 134, datë 30.4.2004, faqe 114 – 240.

Direktivën 2007/66/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 11 dhjetor 2007, e cila ndryshon Direktivat e Këshillit 89/665/KEE dhe 92/13/KEE për përmirësimin e efektshmërisë së procedurave të rishikimit, në lidhje me shpalljen fituese të kontratave publike”, Numri CELEX: 32007L0066, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 335, datë 20.12.2007, faqe 31 – 46.



- b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;
 - c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;
 - ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
 - d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
 - dh) vlerën ose mënyrën e përlllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
 - e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
 - ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
 - f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;
 - g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.”.
3. Në pikën 3 fjalët “krijon një regjistër për” zëvendësohen me fjalën “administron”.
4. Pika 3/1 riformulohet si më poshtë:
- “3/1. Në rastin e prokurimit elektronik, raporti i realizuar nga vetë sistemi, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit me mjete elektronike, bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.”.

Neni 5

Në nenin 13 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “g” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“g) verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, si dhe monitoron mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore.”.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit;”.

b) Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) kur ka një vendim të formës së prerë të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta.”.

3. Në pikën 5 fjalët “personeli tjetër” zëvendësohen me fjalët “stafi ndihmës”.

Neni 6

Nenet 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19 shfuqizohen.

Neni 7

Në nenin 21 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.”.

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë fjalët “sa më shpejt të jetë e mundur, por” hiqen.

b) Në shkronjën “c” fjalët “për karakteristikat dhe avantazhet e ofertës së përzgjedhur” zëvendësohen me fjalët “për klasifikimin e ofertave”.

Neni 8

Në nenin 22 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “me shkrim” shtohen fjalët “ose me mjete elektronike”.

2. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Në rastet kur autoriteti kontraktor komunikon në formë elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese, të disponueshme dhe të ndëroperueshme me produktet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht. Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

3. Në rast se komunikimi ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe autoritetit kontraktor kryhet në ndonjë formë tjetër, të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë nen, përmbajtja e tij duhet të dokumentohet menjëherë me shkrim.”.

Neni 9

Në nenin 23 pika 3, në fund të shkronjës “c” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj””.

Neni 10

Në nenin 24 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:

a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;

b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;

c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;

ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;

d) nëse të gjitha ofertat e pranuar përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;

dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.”.

2. Në pikën 4 fjalët “brenda 10 ditëve” zëvendësohen me fjalët “jo më vonë se 5 ditë”.

Neni 11

Në nenin 26, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rast se në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.”.

Neni 12

Në nenin 29 pika 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) procedurë “shërbim konsulence””.



Neni 13

Në nenin 31 pika 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:
“ç) kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, siç përcaktohen në nenin 55.”.

Neni 14

Në nenin 34 pika 1, në fund të fjalisë së dytë, fjalët “dhe i vlerëson ato në bazë të cilësisë dhe çmimit” hiqen.

Neni 15

Pas nenit 34 shtohet neni 34/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 34/1 Shërbim konsulence

1. Autoriteti kontraktor, që ndërmerr një procedurë “shërbim konsulence”, njofton qëllimin e prokurimit me anë të botimit të njoftimit të kontratës, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e parashikuar në nenin 39 të këtij ligji.

2. Procedurat e hollësishme të zhvillimit të kësaj procedure prokurimi parashikohen në rregullat e prokurimit.”.

Neni 16

Në nenin 36, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pa cenuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe dispozitat e nenit 22 të këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, si më poshtë:

a) informacionet, që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, janë në dispozicion të palëve të interesuara. Mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës;

b) ofertat elektronike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik, si dhe për bazat e të dhënave shtetërore;

c) përpara përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar për dorëzimin e ofertave ose të kërkesave për pjesëmarrje, ofertuesit marrin përsipër të paraqesin dokumentet, certifikatat dhe dëshmitë, të përmendura në nenet 45 dhe 46 të këtij ligji, nëse këto të fundit nuk ekzistojnë në format elektronik.”.

Neni 17

Në nenin 38, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti kontraktor, që kryen procedura prokurimi për kontrata publike me anë të procedurës së hapur, të kufizuar, me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, kërkesës për propozim ose shërbim konsulence, në përputhje me nenet 30, 31, 32, 34 e 34/1 të këtij ligji, ose kur fillon procedurën për konkurs projektimi, sipas nenit 35 të ligjit, bën njoftimin publik për kryerjen e llojit përkatës të prokurimit publik.”.

Neni 18

Në nenin 40, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Autoriteti kontraktor, kur përdor procedurën e kufizuar dhe procedurën me negociim, fton për të paraqitur ofertë të gjithë kandidatët që kualifikohen në fazën e parë të procedurës. Autoriteti kontraktor mund të vazhdojë procedurën e prokurimit vetëm kur janë të paktën 2 kandidatë, me përjashtim të procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit. Në njoftimin për tender, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kriteret objektive, jodiskriminuese, si dhe rregullat që do të zbatohen.”.

Neni 19

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 41

Dokumentet e tenderit

1. Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.

2. Autoriteti kontraktor, kur i kërkohet nga operatorët ekonomikë, do të vërë në dispozicion të të interesuarve dokumentet e tenderit, kundrejt pagesës. Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.”.

Neni 20

Në nenin 42 pika 1, fjalia e fundit hiqet.

Neni 21

Në nenin 46 pika 3, pas fjalëve “dhe të mesëm” shtohen fjalët “dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 22

Në nenin 47, në fjalinë e parë, fjalët “ose një dokument të falsifikuar” hiqen.

Neni 23

Në nenin 48, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë:

a) ofertat dorëzohen me shkrim, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf, me përjashtim të rasteve të përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, kur autoriteti kontraktor, sipas kërkesës, pajis ofertuesit me një dëshmi, ku shënohen data dhe ora e pranimit të ofertës;

b) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore.”.

Neni 24

Në nenin 49 pika 1 shkronja “a”, pas fjalës “vlera” shtohet fjala “e përllogaritur”.

Neni 25

Në nenin 55, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Oferta fituese duhet të jetë:



a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose

b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese.”.

Neni 26

Në nenin 56 pika 1, fjalët “përpara se t’i refuzojë ato” zëvendësohen me fjalët “përpara se t’i kualifikojë ato”.

Neni 27

Në nenin 58 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të fituesit, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik për botimin në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, njoftimi i fituesit dërgohet në platformën elektronike të prokurimit, ditën e nesërme të punës nga marrja e vendimit.

Njoftimi përmban minimalisht këtë informacion:

a) emrat e ofertuesve pjesëmarrës;

b) vlerat e ofertave;

c) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;

ç) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij;

d) ankesa, nëse ka pasur ose jo të tilla.

3. Autoriteti kontraktor dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën, sipas afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në çdo rast kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.”.

2. Pika 5 riformulohet si më poshtë:

“5. Kur ofertuesi fitues nuk arrin të nënshkruajë kontratën ose nuk bën sigurimin e kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura, që kanë mbetur. Në rastin kur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese është përdorur “çmimi më i ulët”, autoriteti do të përzgjedhë ofertuesin e renditur të dytin, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të jetë jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës. Kjo nuk cenon të drejtën e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 të këtij ligji, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e prokurimit. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike.”.

Neni 28

Në nenin 63 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”.

2. Në pikën 2, pas fjalës “ankesa” shtohen fjalët “kundër vendimeve të autoritetit kontraktor”.
3. Në pikën 3, fjalët “të përcaktuar në pikën 5” zëvendësohen me fjalët “të përcaktuara në pikat 5 dhe 6”.
4. Në pikën 6, fjalët “brenda 7 ditëve” zëvendësohen me fjalët “brenda 10 ditëve”.
5. Në pikën 9, fjalët “rregullat e prokurimit publik” zëvendësohen me fjalët “vendimin e Këshillit të Ministrave”.
6. Pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:
“11. Për procedurat e prokurimit, për të cilat nuk bëhet njoftim publik, sipas nenit 38 të këtij ligji, nuk zbatohen dispozitat lidhur me procedurat e rishikimit administrativ.”.

Neni 29

Në nenin 64 pika 4, shkronja “c” hiqet.

Neni 30

Në nenin 64/3, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën përkatëse.”.

Neni 31

Pas nenit 64/3 shtohen nenet 65 dhe 66 me këtë përmbajtje:

“Neni 65

Procedura e hetimit administrativ

1. Agjencia e Prokurimit Publik verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, kur ka fakte të mjaftueshme se ka pasur shkelje të këtij ligji.
2. Gjatë hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë:
 - a) të kryejë hetime administrative në vend, duke përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve ose dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton;
 - b) të kërkojë informacione e shpjegime nga çdo organ i administratës, qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin administrativ;
 - c) të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim dhe të thërrasë të gjithë personat pa imunitet;
 - ç) të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta.
3. Për të realizuar funksionet, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë të ketë akses në të gjitha zyrat e institucioneve të administratës publike, të cilat njihen si autoritete kontraktore, sipas këtij ligji.
4. Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë të caktojë një afat për përgjigjen ndaj kërkesave të saj për informacion dhe për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, sipas legjislacionit që rregullon procedurat administrative.

Neni 66

Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ

1. Pas përfundimit të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:
 - a) të mbyllë hetimin, në qoftë se veprimet ose mosveprimet e autoritetit kontraktor nën hetim nuk përbëjnë shkelje të këtij ligji;



b) të propozojë masë disiplinore ose të vendosë gjobë, në përputhje me nenin 72 të këtij ligji, për shkeljet e gjetura.

2. Në çdo rast, palët do të njoftohen me shkrim për vendimin e marrë.”.

Neni 32

Në kreun IX “Veprimtaria e Avokatit të Prokurimeve”, nenet 69, 70, 71 dhe 71/1 shfuqizohen.

Neni 33

Neni 72 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 72

Kundërvajtjet administrative

1. Mosrespektimi i rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kur përbën kundërvajtje administrative dënohet me masë disiplinore ose me gjobë, si më poshtë:

a) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji dënohet me gjobë 1 000 000 lekë;

b) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 12 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 15 000 deri në 30 000 lekë;

c) mospërbushja e detyrimit për formën e komunikimit, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

ç) mospërbushja e detyrimit të parashikuar në nenin 23 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë;

d) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

dh) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 1 000 000 lekë;

e) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 38 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë;

ë) mospërbushja e njërit prej detyrimeve të përcaktuara në nenet 39, 40, 41 e 42 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë;

f) mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 500 000 lekë;

g) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 53 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;

gj) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 56 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

h) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 63 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 1 000 000 lekë;

i) personat, që përpiqen të ndikojnë në vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me nenin 19/7 të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

2. Në të gjitha rastet e mësipërme, kur personat përgjegjës nuk dënohen me gjobë, dhe në çdo rast tjetër të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, kërkohet dhënia e masave disiplinore ndaj tyre.

3. Personat e interesuar, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, mund të bëjnë ankim në gjykatë.”.

Neni 34

Në nenin 73, fjalët “dhe Avokatin e Prokurimeve” hiqen.

Neni 35

Avokati i Prokurimeve dhe stafi i tij, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e ligjit, Avokati i Prokurimeve i dorëzon Kuvendit bazën materiale dhe arkivin.

Neni 36
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Miraturar në datën 27.12.2012

DEKRET
Nr. 7896, datë 27.12.2012

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË
TË LIGJIT**

Në mbështetje të neneve 93 dhe 84, pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:

NENI 1

Shpalljen e ligjit nr.131/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 131/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 854, datë 4.12.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS DËRMENAS TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Dërmenas të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 707 (shtatëqind e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dërmenas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dërmenas

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-16, 371	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
36-42, 380-383	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
17-29, 372	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
85-99	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
43-52, 384-385	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
56-84, 347-348, 386, 389-398	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
30-35, 316, 322-323, 329-333, 339, 343-346, 364, 367	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
315, 317-321, 324-328, 334-338, 340-342, 352, 355, 359-362, 366, 368	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
137, 399-409, 412-413, 417-418, 420, 426-427, 432, 436-446, 451, 467, 481, 484, 486-488, 495, 497-498, 501-504, 506-509, 512, 515, 517-518, 520, 525-526, 530-531, 545, 547-554, 557-558, 560-562, 564-565, 567-597, 599-633, 647-666	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
130-136, 138-140, 410-411, 414-416, 419, 421-425, 428-431, 433-435, 447-450, 452-466, 468-480, 482-483, 485, 489-494, 496, 499-500, 505, 510-511, 513-514, 516, 519, 521-524, 527-529, 532-544, 546, 555-556, 559, 563, 566, 598, 634-642, 644-646, 143, 154, 182, 195, 217, 224, 245, 259, 272, 292, 294, 301 (vetëm kanale të treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
356-358, 365, 369-370, 387-388	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 855, datë 4.12.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS ALLKAJ TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Allkaj të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 227 (dyqind e njëzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Allkaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Allkaj

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
6	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive kulturore	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11-13, 15-23, 27, 33, 197-218	Infrastrukturë (troje, rrugë vendore)	Në pronësi
31, 39	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
40-44	Shërbim funeral	Në pronësi
45-81	Mbrojtje civile	Në pronësi
174, 177, 179, 181, 184, 187, 189, 192	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
96, 112, 134, 147, 156, 163, 172, 175, 176, 178, 180, 182, 183, 185, 186, 188, 190, 191, 193	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi



VENDIM
Nr. 856, datë 4.12.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SHALË TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shalë të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Shalë të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr. 68, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Shalë të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Shalë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Shalë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
452-464	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
563	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
466, 467	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
468-478	Varrezat publike	Në pronësi
479-489, 561, 562, 564-567	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
491-501	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
502-519	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
520	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
521-530	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
532-534	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 857, datë 4.12.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS MESOPOTAM TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Mesopotam të qarkut të Vlorës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 126 (njëqind e njëzet e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 905 (nëntëqind e pesë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Mesopotam për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Mesopotam

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
202-214	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të arsimit	Në pronësi
215-226, 904, 905	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
227-241	Shërbime funerale	Në pronësi
242-296, 588-804	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
297-541	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
542-543	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në administratë	Në pronësi
548-551	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e kulturës dhe sporteve	Në pronësi
842-844, 846-848, 850-852, 854-857, 859-861, 863-864, 866-868, 871-873, 875-877, 879-880, 882-884	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore produktive)	Në përdorim
845, 849, 853, 858, 862, 865, 869-870, 874, 878, 881, 885	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore joproduktive)	Në pronësi
886-900	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi



VENDIM
Nr. 858, datë 4.12.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 903, DATË 21.12.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI APO NË
PËRDORIM TË KOMUNËS TREBISHT TË QARKUT TË DIBRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së ndryshuar të inventarit të pronave të paluajtshme të tipit, pyje dhe kullota, dhe transferimin e tyre në pronësi të komunës Trebisht të qarkut të Dibrës. Lista është me 4 (katër) fletë me numër prone 25 - 118 dhe 157 - 177.

2. Lista e ndryshuar e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të komunës dhe lidhja numër 1 (një) me llojin e transferimit i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Trebisht e qarkut të Dibrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Trebisht
Qarku Dibër

Lidhja nr. 1

Numrat e pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
25-118, 157-177	Pyje dhe kullota	Pronësi

VENDIM
Nr. 859, datë 4.12.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 299, DATË 12.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN STRAVAJ TË QARKUT TË ELBASANIT”
DHE MIRATIMIN E LISTËS SË PRONAVE TË TIPIT PYJE DHE KULLOTA, QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KËSAJ KOMUNE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2, 3 dhe 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së ndryshuar të inventarit të pronave të paluajtshme të tipit pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Stravaj të qarkut të Elbasanit.

Lista është me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë, me numër prone në listën e inventarit 232 deri në 852 dhe 916 deri në 980.

2. Miratimin e listës së pronave të tipit pyje dhe kullota që transferohen në pronësi të kësaj komune.

Lista ka 8 (tetë) fletë dhe mbaron me numër rendor 301.

3. Lista me ndryshimet në inventar, lista e pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të kësaj komune dhe lidhja numër 1, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Stravaj e qarkut të Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Stravaj
Qarku Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat e pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
236-295, 330-332, 334-335, 337-340, 343-345, 347-348, 352-354, 360-361, 365-373, 468-478, 487, 490-516, 521-530, 541-545, 551-552, 556, 595-596, 598, 600-601, 603-638, 700-707, 722-732, 805-848, 919-980	Pyje, kullota	Pronësi

VENDIM

Nr. 860, datë 4.12.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 916, DATË 29.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN VËRTOP TË QARKUT TË BERATIT” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 417, DATË 8.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE PYJE DHE KULLOTA QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA VËRTOP TË QARKUT TË BERATIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2, 3 dhe 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së ndryshuar të inventarit të pronave të paluajtshme të tipit pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Vërtop.

Lista është me 20 (njëzet) fletë, fillon me numër rendor 171 dhe mbaron me numër 632.

2. Miratimin e listës së ndryshuar të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të kësaj njësie.



Lista ka 12 (dymbëdhjetë) fletë dhe mbaron me numër rendor 267.

3. Listat me ndryshimet në inventar dhe ndryshimet në listën e pyjeve/kullotave që transferohen në pronësi dhe lidhja numër 1, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Vërtop e qarkut të Beratit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Vërtop
Qarku Berat

Lidhja nr. 1

Numrat e pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
171-260, 264-322, 363-391, 402-413, 483-493, 526-565, 587-611, 628-632	Pyje, kullota dhe sipërfaqe me bimësi pyjore	Në pronësi

VENDIM
Nr. 861, datë 4.12.2012

**PËR LEJIMIN E QENDRËS SË KULTURËS, MEDIAS DHE BOTIMEVE TË MBROJTJES, SI
AUTORITET KONTRAKTOR, PËR LIDHJE KONTRATE SHITESË RIKONSTRUKSIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes, si autoritet kontraktor të realizojë, brenda datës 31.12.2012, lidhjen e kontratës shtesë për objektin “Rikonstruksion i hotelit të ish-ushtarakëve ESKU”, me fond limit 41 515 922 (dyzet e një milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e dy) lekë me TVSH.

Brenda këtij afati përfshihet edhe njoftimi i kontratës së nënshkruar.

2. Ngarkohen Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 865, datë 4.12.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 535, DATË 7.8.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT
TË LARTË PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME, E TË
EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2012-2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” të ligjit 104/1992 “Ligji kuadër për asistencën, integrimin social dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 535, datë 7.8.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Rishpërndarja e kuotave të pikës 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të porealizuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

Kuotat e çdo programi studimi ndahen në raportin 7:3, përkatësisht 70% e tyre për pranimet e reja, për programe të para studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe 30% për pranimet e reja për programe të dyta studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 866, datë 4.12.2012

PËR BATERITË, AKUMULATORËT DHE MBETJET E TYRE²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja, ruajtja e përmirësimi i cilësisë së mjedisit, si dhe mbrojtja e shëndetit publik, përmes minimizimit të ndikimeve negative nga bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre.

2. Vendimi synon:

- a) të përcaktojë rregulla për hedhjen në treg të baterive dhe akumulatorëve;
- b) të ndalojë hedhjen në treg të baterive dhe akumulatorëve që përmbajnë substanca të rrezikshme;
- c) të maksimizojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve;
- ç) të nxisë një nivel të lartë riciklimi;
- d) të pakësojë sasitë e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve që asgjësohen së bashku me mbetje të përziera bashkiake;
- dh) të përmirësojë performancën në mjedis të të gjithë operatorëve ekonomikë të përfshirë në ciklin e jetës së baterive dhe akumulatorëve, që nga prodhuesit, shpërndarësit e përdoruesit përfundimtarë dhe, në veçanti, të operatorëve të përfshirë drejtpërdrejt në trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve.

KREU II
FUSHA E ZBATIMIT

1. Ky vendim zbatohet për të gjitha llojet e baterive dhe akumulatorëve, pavarësisht nga forma, volumi, pesha, materialet përbërëse ose përdorimi.

2. Ky vendim nuk zbatohet për bateritë dhe akumulatorët e përdorur në:

- a) pajisjet që lidhen me mbrojtjen e interesave themelore të sigurisë së shtetit, të armëve, municioneve dhe materialeve të luftës, me përjashtim të produkteve që nuk janë parashikuar specifikisht për qëllime ushtarake;
- b) pajisjet e projektuara për t’u dërguar në hapësirë.

² CELEX Reference 32006L0066

- Projektvendimi transponon direktivën 2006/66/EC, të Parlamentit dhe Këshillit Europian, të datës 6 shtator 2006 “Për bateritë dhe akumulatorët, mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët” (hyrë në fuqi në datën 5.12.2008), të amenduar nga direktiva 2008/12/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 11 mars 2008 dhe nga direktiva 2008/103/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 19 nëntor 2008;

- Vendimin e Komisionit 2008/763/EC në vijim të direktivës 2006/66/EC, të Parlamentit dhe Këshillit Europian që përcakton metodikën e llogaritjes së shitjeve vjetore të përdoruesit përfundimtar të baterive dhe akumulatorëve portativë;

- Vendimin e Komisionit 2009/603/EC, të datës 5 gusht 2009 “Për përcaktimin e kërkesave për procedurat e regjistrimit të baterive dhe akumulatorëve në përputhje me direktivën 2006/66/EC, të Parlamentit dhe Këshillit Europian, të datës 6 shtator 2006 “Për bateritë dhe akumulatorët, mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët”.

KREU III PËRKUFIZIMET

1. Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, kanë të njëjtin kuptim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Agjencia”, autoriteti publik, siç përcaktohet në seksionin 1 të kreut X të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

b) “Bateri ose akumulator portativ”, çdo bateri, pilë, paketë baterish ose akumulator që:

c/1 është vulosur;

c/2 mund të mbahet në dorë;

c/3 nuk është as bateri ose akumulator industrial, as bateri ose akumulator automotiv.

c) “Bateri ose akumulator automotiv”, çdo bateri ose akumulator i përdorur për ndezje, ndriçim ose energji ndezjeje.

ç) “Hedhja në treg”, furnizimi, vënia në dispozicion ose importi i baterive dhe/ose akumulatorëve.

d) “Mbetje të baterive dhe akumulatorëve”, ato bateri dhe akumulatorë, të cilët mbajtësi ka për qëllim t’i hedhë, i hedh ose i kërkohet që t’i hedhë.

dh) “Pajisje”, çdo aparaturë elektrike ose elektronike që merr energji pjesërisht ose plotësisht nga bateritë ose akumulatorët.

e) “Paketë baterish”, disa bateri ose akumulatorë që janë të lidhur së bashku dhe/ose të mbyllura brenda së njëjtës mbulesë të jashtme dhe që përbëjnë një njësi të vetme, që përdoruesi përfundimtar nuk e ndan ose nuk e hap.

ë) “Përqindja e grumbullimit” në nivel kombëtar gjatë një viti kalendarik nënkupton përqindjen që rezulton nga pjesëtimi i peshës së mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve portativë të grumbulluar sipas kreut X të këtij vendimi (skemat e grumbullimit), gjatë atij viti kalendarik, me peshën mesatare të baterive dhe akumulatorëve portativë që prodhuesit i shesin drejtpërdrejt te përdoruesit përfundimtarë ose i shpërndajnë te palët e treta, me qëllim që këto t’ua shesin përdoruesve përfundimtarë gjatë atij viti kalendarik dhe gjatë dy viteve të mëparshme.

f) “Pilë në formë kopse”, çdo bateri portative e vogël, e rrumbullakët ose akumulator që e ka diametrin më të madh se lartësia e vet dhe që përdoret për qëllime të veçanta, si p.sh. në aparate dëgjimi, orë, pajisje të vogla portative dhe pajisje për energji emergjence.

g) “Prodhues”, çdo person, fizik dhe/ose juridik, që hedh në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, mbi baza profesionale, bateri ose akumulatorë, përfshirë ato që janë të instaluar në strukturën e pajisjeve ose automjeteve, pavarësisht nga teknika që përdor për shitjen e tyre, ku përfshihen edhe mjetet e komunikimit në distancë.

gj) “Shpërndarës”, çdo person që siguron bateri dhe akumulatorë, sipas parimit profesional për përdoruesit përfundimtarë.

h) “Vegël elektrike pa kablo”, çdo pajisje që mund të mbahet në dorë, që ushqehet me bateri ose akumulator dhe që përdoret për aktivitete të mirëmbajtjes, ndërtimit ose kopshtarisë.

KREU IV REGJISTRIMI I PRODHUESVE

1. Prodhuesit e baterive dhe akumulatorëve përpara se të hedhin në treg për herë të parë, mbi baza profesionale, bateri dhe akumulatorë, pajisen me leje mjedisi të kategorisë III.1, e parashikuar në fushën III të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, regjistrohen në regjistrin e prodhuesve të baterive dhe akumulatorëve, që Agjencia krijon për këtë qëllim, dhe pajisen me një numër regjistrimi.

2. Regjistrimi bëhet vetëm një herë në momentin kur hedh në treg bateri e akumulatorë për herë të parë, mbi baza profesionale.



3. Regjistrimi në Agjenci, për qëllime të këtij vendimi, përfshin vetëm infomacionin e mëposhtëm:

- a) emrin e prodhuesit dhe të markës, nëse ka, me të cilin operon në Republikën e Shqipërisë;
- b) adresa/t e plotë/a e/të prodhuesit: kodin postal dhe vendndodhjen, emrin e rrugës dhe numrin, faqen e internetit, adresën e *e-mail*-it, kutinë postare, numrin e telefonit dhe të faksit, personin e kontaktit;
- c) të dhënat për tipin e baterive dhe akumulatorëve të hedhur në treg nga prodhuesi: bateri dhe akumulatorë portativë, industrialë apo automotivë;
- ç) informacion për mënyrën se si prodhuesi përmbush detyrimet e tij;
- d) datën e aplikimit për regjistrim;
- dh) kopje të regjistrimit në QKR, përfshirë numrin e NIPT-it në Republikën e Shqipërisë;
- e) deklaratën që pohon se informacioni i dhënë është i vërtetë.

4. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, njoftojnë agjencinë për çdo ndryshim që mund të pësojë informacioni i dhënë në pikën 3, jo më vonë se 1 (një) muaj pas atij ndryshimi.

5. Subjektet e përcaktuara në pikën 1, kur pushojnë aktivitetin e tyre të prodhimit të baterive dhe akumulatorëve dhe nuk e ushtrojnë më këtë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, kërkojnë me anë të një kërkesë me shkrim, drejtuar agjencisë, çregjistrimin nga regjistri i prodhuesve të baterive dhe akumulatorëve.

6. Agjencia bën çregjistrimin e operatorëve të përcaktuar në pikën 1 nga regjistri i prodhuesve të baterive dhe akumulatorëve dhe njofton, me shkrim, kërkuesin, për kryerjen e çregjistrimit.

7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon dhe administron Regjistrin e Prodhuësve të baterive dhe akumulatorëve. Formatit dhe mënyra e administrimit të regjistrit, miratohen me udhëzim të ministrit.

KREU V HEDHJA NË TREG

1. Lejohen të hidhen në treg bateritë dhe akumulatorët që plotësojnë kërkesat e këtij vendimi dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2001.

2. Ndalohet hedhja në treg e baterive dhe akumulatorëve që nuk plotësojnë kërkesat e këtij vendimi.

KREU VI NDALIME PËR HEDHJEN NË TREG

1. Ndalohet hedhja në treg:

a) e baterive ose akumulatorëve, të instaluar ose jo në pajisje që përmbajnë merkur më shumë se 0,0005% të peshës së tyre;

b) e baterive ose akumulatorëve portativë, përfshirë ato të instaluar në pajisje që përmbajnë kadmium më shumë se 0,002% të peshës së tyre.

2. Kufizimi i caktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij kreu, nuk zbatohet për pilat në formë kopse, që përmbajnë merkur jo më shumë se 2% të peshës së tyre.

3. Kufizimi i caktuar në shkronjën "b" të pikës 1, nuk zbatohet për bateritë dhe akumulatorët portativë që përdoren në:

a) sistemet e alarmit dhe të emergjencës, përfshirë ndriçimin e emergjencës;

b) pajisjet mjekësore;

c) veglat elektrike pa kablo.

KREU VII ETIKETIMI

1. Prodhuësit e baterive, akumulatorëve dhe paketave të baterive i etiketojnë ato me simbolin e treguar në aneksin II.

2. Prodhuesit e baterive dhe akumulatorëve portativë dhe automotivë shënojnë mbi to, në një formë të dukshme, të lexueshme dhe të pashqitshme kapacitetin e tyre, 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Prodhuesit e baterive, akumulatorëve dhe baterive në formë kopse, që përmbajnë më shumë se 0,0005% merkur, më shumë se 0,002% kadmium ose më shumë se 0,004% plumb, i etiketojnë këto me simbolin kimik të metaleve: Hg, Cd ose Pb. Simboli që tregon përmbajtjen e metaleve të rënda printohet poshtë simbolit të treguar në aneksin II dhe mbulon një sipërfaqe të paktën sa 1/4 e sipërfaqes së këtij simboli.

4. Prodhuesit sigurojnë që simboli i treguar në aneksin II të mbulojë të paktën 3% të sipërfaqes së anës më të madhe të baterisë, akumulatorit ose pakos së baterisë, deri në përmasa maksimale prej 5×5 cm. Në rastin e pilave cilindrike, simboli mbulon të paktën 1,5% të sipërfaqes së baterisë ose akumulatorit dhe ka përmasa maksimale prej 5×5 cm.

5. Kur përmasa e baterisë, akumulatorit ose pakos së baterive është më e vogël se $0,5 \times 0,5$ cm, prodhuesit nuk i etiketojnë ato, por në paketim printojnë një simbol me përmasa të paktën 1×1 cm.

6. Prodhuesit i printojnë simbolet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe në mënyrë të tillë që nuk shqitet nga produkti.

KREU VIII

INFORMACION PËR HEQJEN E MBETJEVE TË BATERIVE DHE AKUMULATORËVE

1. Prodhuesit i projektojnë pajisjet në mënyrë të tillë që mbetjet e baterive dhe akumulatorëve të hiqen lehtësisht.

2. Prodhuesit i shoqërojnë pajisjet që përmbajnë bateri dhe akumulatorë të instaluar brenda tyre me udhëzime përkatëse:

a) që tregojnë se si mund të hiqen në mënyrë të sigurt dhe kur heqja është e nevojshme;

b) që informojnë përdoruesit përfundimtarë për llojin e baterive dhe akumulatorëve të inkorporuar.

3. Kërkesat e pikës 2 të këtij kreu, nuk zbatohen në rastet kur për arsye sigurie, performance, mjekësore ose të ruajtjes së integritetit të të dhënave është i nevojshëm furnizimi i vazhdueshëm me energji dhe kërkohet që lidhja midis pajisjes dhe baterisë ose akumulatorit të jetë e vazhdueshme.

KREU IX

PËRMIRËSIMI I PERFORMANCËS MJEDISORE

Ministria dhe ministria përgjegjëse për ekonominë nxisin kërkimet dhe inkurajojnë zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis nga bateritë dhe akumulatorët gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, si dhe zhvillimin dhe marketingun për bateritë dhe akumulatorët që përmbajnë sasi më të vogla të substancave të rrezikshme ose më pak substanca ndotëse e, sidomos, substanca që zëvendësojnë merkurin, kadmiumin dhe plumbin.

KREU X

SKEMAT E GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE TË BATERIVE DHE AKUMULATORËVE

1. Prodhuesit dhe/ose shpërndarësit, të cilët janë të pajisur me licencën e nënkategorisë III.2.B, marrin masat e nevojshme për vënien në funksionim të skemave të grumbullimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve portativë, nëpërmjet të cilëve:

a) u japin mundësi përdoruesve përfundimtarë të hedhin mbetjet e baterive dhe akumulatorëve portativë në pika të afërta grumbullimi lehtësisht të aksesueshme prej tyre, siç janë pikat e shitjes së baterive dhe akumulatorëve portativë, duke marrë në konsideratë densitetin e popullsisë;

b) informojnë përdoruesit përfundimtarë për mundësinë e kthimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve portativë në pikat e tyre të shitjes;



c) marrin mbrapsht nga pikat e shitjes mbetjet e baterive dhe akumulatorëve portativë të grumbulluara sa herë që furnizojnë me bateri dhe akumulatorë portativë pikat e shitjes, me përjashtim të rasteve kur janë bërë vlerësime nga organet përgjegjëse që tregojnë se skema të tjera ekzistuese janë të paktën po aq efektive për arritjen e qëllimeve të këtij vendimi;

ç) nuk vendosin asnjë tarifë për t'u paguar nga përdoruesit përfundimtarë dhe as nuk i detyrojnë ata të blejnë bateri ose akumulatorë të rinj në çastin kur i dorëzojnë mbetjet e baterive dhe akumulatorëve portativë.

2. Skemat e grumbullimit zbatohen edhe për bateritë dhe akumulatorët e importuar, duke zbatuar kushte jodiskriminuese, duke shmangur barrierat e tregtisë dhe konkurrencën e pandershme.

3. Inspektorati shtetëror për mjedisin dhe strukturat e tjera shtetërore të ngarkuara nga ligji marrin masa që:

a) prodhuesit të ngrenë skema që plotësojnë kërkesat e përmendura në pikën 1 të këtij kreu;

b) operatorët e tjerë ekonomikë të marrin pjesë në këto skema;

c) subjektet e shkronjave "a" e "b" të pikës 3 të këtij kreu të mirëmbajnë këto skema.

4. Prodhuesit e baterive dhe akumulatorëve industrialë ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre nuk refuzojnë të marrin mbrapsht nga përdoruesit përfundimtarë mbetjet e baterive dhe akumulatorëve industrialë, pavarësisht përmbajtjes kimike dhe origjinës. Edhe palët e treta të pavarura mund të grumbullojnë bateri dhe akumulatorë industrialë.

5. Prodhuesit e baterive dhe akumulatorëve automotivë ose palët e treta ngrenë skema për grumbullimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve automotivë nga përdoruesit përfundimtarë ose nga një pikë grumbullimi në afërsi të tyre. Në rastin e baterive dhe akumulatorëve automotivë të automjeteve private, jotregtare, këto skema nuk vendosin asnjë tarifë për përdoruesit përfundimtarë dhe as nuk i detyrojnë ata të blejnë bateri ose akumulatorë të rinj kur dorëzojnë mbetjet e tyre.

6. Prodhuesit, shpërndarësit dhe palët e treta që veprojnë në emër të tyre, përdorin instrumente ekonomike (sisteme të rimbursimit të pagesave etj.), që nxisin:

a) grumbullimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve; dhe/ose

b) përdorimin e baterive dhe akumulatorëve që përmbajnë më pak substanca ndotëse.

7. Të gjithë operatorët ekonomikë dhe autoritetet publike përfshihen dhe marrin pjesë, sipas rastit, në skemat e grumbullimit, trajtimit dhe riciklimit, sipas këtij vendimi.

KREU XI

PËRQINDJET E GRUMBULLIMIT DHE MONITORIMI I TYRE

1. Prodhuesit, shpërndarësit e baterive dhe akumulatorëve, si dhe palët e treta, që veprojnë në emër të tyre regjistrojnë, për çdo vit kalendarik, shitjet e baterive dhe akumulatorëve e në çdo rast ky regjistrim evidentohet dhe bëhet nëpërmjet një dokumenti dorëzimi, që firmoset nga të dyja palët, përkatësisht:

a) shitja, kalimi apo çdo formë tjetër transaksioni e baterive dhe akumulatorëve ndërmjet subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, apo ndërmjet tyre dhe palëve të treta;

b) kalimi apo çdo formë tjetër transaksioni i mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve nga pikat e shitjes te prodhuesit/shpërndarësit apo palët e treta;

c) kalimi apo çdo formë tjetër transaksioni i mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve nga grumbulluesi te ricikluesi/rikuperuesi;

ç) Një kopje e dokumenteve të dorëzimit, të përmendura në shkronjat "a", "b" e "c" të këtij kreu, dorëzohet në njësitë përkatëse të qeverisjes vendore dhe në agjenci, bashkë me raportet sipas këtij vendimi;

d) Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij kreu, duhet të ruajnë për një periudhë kohore jo më pak se dy vjet dokumentet e dorëzimit, si dhe aktet e tjera që vërtetojnë të dhënat që përmban dokumenti i dorëzimit.

2. Të dhënat për shitjet dhe grumbullimin vjetor përfshijnë edhe bateritë dhe akumulatorët e instaluar brenda pajisjeve të ndryshme.

3. Shitjet vjetore të baterive dhe akumulatoreve portativë te përdoruesit përfundimtarë llogariten mbi bazën e peshës së tyre të hedhur në treg gjatë atij viti kalendarik, duke zbritur peshën e baterive dhe akumulatoreve portativë që janë nxjerrë jashtë vendit para se t'u shiten përdoruesve përfundimtarë. Hedhja në treg e secilës bateri numërohet vetëm një herë.

4. Prodhuesit, shpërndarësit e baterive dhe akumulatoreve dhe palët e treta, që përfshihen në grumbullimin e mbetjeve të tyre, regjistrojnë për çdo vit kalendarik mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët e grumbulluar.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave regjistron importet dhe eksportet e baterive dhe akumulatoreve portativë dhe eksportet e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët sipas legjislacionit në fuqi.

6. Subjektet e përcaktuara në pikën 4 të këtij kreu, llogarisin përqindjet e grumbullimit sipas tabelës së paraqitur në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Subjektet e përcaktuara në pikën 4 të këtij kreu, brenda datës 31 janar të çdo viti, raportojnë në njësitë e qeverisjes vendore, ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre, sipas aneksit I, të plotësuar për vitin paraardhës.

8. Njësitë e qeverisjes vendore llogarisin përqindjet e grumbullimit, të realizuara në territorin ku shtrijnë juridiksionin e tyre gjatë vitit kalendarik paraardhës dhe i regjistrojnë ato në regjistrat e tyre të krijuar për këtë qëllim.

9. Njësitë e qeverisjes vendore raportojnë në agjenci, brenda muajit prill të çdo viti, përqindjet e realizuara të grumbullimit për vitin paraardhës, sipas tabelës së paraqitur në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton në agjenci, brenda muajit mars të çdo viti, importet dhe eksportet e baterive e akumulatoreve portativë, si dhe eksportet e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët për vitin paraardhës, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Agjencia llogarit përqindjet e grumbullimit, të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe i regjistron ato në regjistrat e krijuar për këtë qëllim.

12. Agjencia i përfshin rezultatet e përqindjeve të grumbullimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatoreve në raportet e gjendjes së mjedisit.

13. Ministria i vendos rezultatet e këtij monitorimi në dispozicion të publikut.

14. Përqindjet minimale të detyrueshme të grumbullimit në nivel kombëtar, në përputhje me strategjinë dhe planin kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve, janë këto:

a) brenda vitit 2015 - 25%;

b) brenda vitit 2025 - 65%.

15. Përqindjet e përcaktuara në pikën 14 të këtij kreu, janë të detyrueshme për çdo prodhues, shpërndarës, apo palët e treta që veprojnë në emër të tyre.

KREU XII RICIKLIMI, TRAJTIMI DHE ASGJËSIMI

1. Prodhuesit ose palët e treta marrin masat e nevojshme në mënyrë që 3 (tre) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi:

a) të krijojnë skema për trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatoreve, duke përdorur teknikat më të mira të disponueshme që mbrojnë shëndetin dhe mjedisin;

b) bateritë dhe akumulatorët e identifikueshëm, të grumbulluar sipas këtij vendimi, t'i nënshtrohen trajtimit dhe riciklimit sipas skemave që plotësojnë minimalisht kërkesat e legjislacionit në fuqi, në veçanti të atij për shëndetin, sigurinë dhe menaxhimin e mbetjeve.

2. Mbetjet e baterive dhe akumulatoreve të grumbulluar që përmbajnë kadmium, merkur ose plumb lejohen të asgjësohen në lëndfillin për mbetjet e rrezikshme ose në depozita nëntokësore, vetëm në rast se:

a) nuk ekziston asnjë treg përfundimtar për to;



b) ekziston një akt ligjor apo nënligjor që ka miratuar një strategji kombëtare për ndalimin e përdorimit të metaleve të rënda, i cili në bazë të një studimi të detajuar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ekonomik dhe social, tregon se asgjësimi është një zgjedhje më e preferueshme se riciklimi.

3. Ministria bën të disponueshëm për publikun studimin, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën “b” të pikës 2.

4. Operatorët marrin masat e nevojshme që trajtimi të plotësojë kërkesat minimale të pjesës A të aneksit III.

5. Operatorët që grumbullojnë pajisje elektrike dhe elektronike, në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, së bashku me bateri dhe akumulatorë të instaluar brenda tyre, heqin prej tyre bateritë dhe akumulatorët.

6. Operatorët e angazhuar në procesin e riciklimit marrin masat e nevojshme në mënyrë që jo më vonë se 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të plotësojnë kërkesat e pjesës B, të aneksit III, bashkëlidhur këtij vendimi, lidhur me frytshmërinë e riciklimit.

7. Ndalohet asgjësimi në lëndfill ose incinerator i mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve industrialë dhe automotivë.

8. Lejohet asgjësimi në lëndfillin për mbetjet e rrezikshme ose incinerator i mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve që i janë nënshtruar trajtimit dhe riciklimit sipas këtij vendimi.

KREU XIII TEKNOLOGJITË E REJA TË RICIKLIMIT

1. Ministria dhe organet përgjegjëse për progresin teknik e teknologjik inkurajojnë zhvillimin e teknologjive të reja të riciklimit e trajtimit dhe nxisin kërkime për metoda riciklimi për bateritë dhe akumulatorët, që nuk ndikojnë negativisht në mjedis dhe kanë kosto të ulët.

2. Ministria dhe ministria përgjegjëse për ekonominë inkurajojnë operatorët që merren me trajtimin e baterive dhe akumulatorëve të fillojnë të zbatojnë skema të certifikuara për menaxhimin e mjedisit (EMAS).

KREU XIV FINANCIMI

1. Prodhuesit ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre, marrin masa, që:

a) të financojnë të gjitha kostot neto që kanë të bëjnë me grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e të gjitha mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve portativë, industrialë dhe automotivë të grumbulluara sipas këtij vendimi;

b) të arrijnë marrëveshje, sipas rastit, me përdoruesit e baterive dhe akumulatorëve industrialë dhe automotivë, duke përcaktuar rregullime financiare, përveç atyre të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) të financojnë të gjitha kostot neto që lidhen me fushatat informuese publicitare për grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve portativë.

2. Zbatimi i kërkesave të përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij kreu, bëhet duke shmangur pagesat e dyfishta të prodhuesve në rastin e baterive dhe akumulatorëve të grumbulluar sipas skemave të krijuara, në zbatim të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” dhe legjislacionit që rregullon menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës.

3. Prodhuesit dhe shpërndarësit, në kohën e shitjes së baterive dhe akumulatorëve portativë të rinj te përdoruesit përfundimtarë nuk ua tregojnë këtyre të fundit veçmas kostot respektive të grumbullimit, trajtimit dhe riciklimit.

4. Ky kre zbatohet për të gjitha mbetjet e baterive dhe akumulatorëve, pavarësisht nga data e hedhjes së tyre në treg.

**KREU XV
LEJA E MJEDISIT DHE LICENCA**

1. Prodhuesit e baterive dhe akumulatorëve të të gjithë tipave pajisen me leje mjedisi të kategorisë III.1, të parashikuar në fushën III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

2. Operatorët që angazhohen me menaxhimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve të të gjithë tipave pajisen me licencë të nënkategorisë III.2.B dhe leje mjedisore të kategorisë III.1, të parashikuara në fushën III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

**KREU XVI
INFORMIMI I PËRDORUESVE PËRFUNDIMTARË**

Prodhuesit dhe shpërndarësit dhe/ose njësitë e qeverisjes vendore, individualisht ose në bashkëpunim ndërmjet tyre, organizojnë fushata informuese për përdoruesit përfundimtarë lidhur me:

- a) efektet potenciale, në shëndet dhe në mjedis, të substancave të përdorura në bateri dhe akumulatorë;
- b) rregullat për moshedhjen e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve si mbetje të pandara shtëpiake/inerte dhe nevojën për grumbullimin e veçuar të tyre, për të lehtësuar trajtimin dhe riciklimin;
- c) skemat e grumbullimit dhe riciklimit që janë në dispozicion të tyre;
- ç) rolin dhe kontributin e tyre në procesin e riciklimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve;
- d) kuptimin e simbolit të koshit me rrota me një kryq përsipër, që tregohet në aneksin II, bashkëlidhur këtij vendimi dhe të simboleve kimike Hg, Cd dhe Pb.

**KREU XVII
ORGANET PËRGJEGJËSE**

1. Ministria, ministria përgjegjëse për ekonominë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, njësitë e qeverisjes vendore dhe të gjithë operatorët ekonomikë të përmendur në këtë vendim ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

2. Për detyrimin e vendosjes në treg të akumulatorëve dhe baterive sipas kërkesave të këtij vendimi dhe për marrjen e masave të parashikuara në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2001 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, ngarkohet struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

LLOGARITJA E PËRQINDJEVE TË GRUMBULLIMIT

Viti	Të dhënat	Llogaritja	Kërkesa për raportim
X (*)+1	Shitjet në vitin e parë (S1)		
X+2	Shitjet në vitin e dytë (S2)		
X+3	Shitjet në vitin e tretë (S3)	Grumbullimi në vitin e tretë (C3)	Norma e grumbullimit (CR3) $= 3 * C3 / (S1 + S2 + S3)$
X+4	Shitjet në vitin e katërt (S4)	Grumbullimi në vitin e katërt (C4)	Norma e grumbullimit (CR4) $= 3 * C4 / (S2 + S3 + S4)$ (objektivi i caktuar 25%)



X+5	Shitjet në vitin e pestë (S5)	Grumbullimi në vitin e pestë (C5)	Norma e grumbullimit (CR5) $= 3 \cdot C5 / (S3 + S4 + S5)$	CR4
X+6	Shitjet në vitin e gjashtë (S6)	Grumbullimi në vitin e gjashtë (C6)	Norma e grumbullimit (CR6) $= 3 \cdot C6 / (S4 + S5 + S6)$	CR5
X+7	Shitjet në vitin e shtatë (S7)	Grumbullimi në vitin e shtatë (C7)	Norma e grumbullimit (CR7) $= 3 \cdot C7 / (S5 + S6 + S7)$	CR6
X+8	Shitjet në vitin e tetë (S8)	Grumbullimi në vitin e tetë (C8)	Norma e grumbullimit (CR8) $= 3 \cdot C8 / (S6 + S7 + S8)$ (objektivi i caktuar 45%)	CR7
X+9	Shitjet në vitin e nëntë (S9)	Grumbullimi në vitin e nëntë (C9)	Norma e grumbullimit (CR9) $= 3 \cdot C9 / (S7 + S8 + S9)$	CR8
X+10	Shitjet në vitin e dhjetë (S10)	Grumbullimi në vitin e gjashtë (C10)	Norma e grumbullimit (CR10) $= 3 \cdot C10 / (S8 + S9 + S10)$	CR9
X+11	etj.	etj.	etj.	CR10
etj.				

(*) Viti X është viti i miratimit të këtij vendimi.

Simbolet për bateritë, akumulatorët dhe paketat e baterive për qëllime të grumbullimit të diferencuar të tyre

Simboli që tregon “grumbullimin e diferencuar” për të gjitha bateritë dhe akumulatorët është një karrocë me rrota me një kryq përsipër, si tregohet në figurën më poshtë:



ANEKSI III KËRKESA TË DETAJUARA PËR TRAJTIMIN DHE RICIKLIMIN

Pjesa A: Trajtimi

1. Trajtimi, minimalisht, përfshin heqjen e të gjitha lëngjeve dhe acideve.
2. Trajtimi dhe magazinimi, përfshirë magazinimin e përkohshëm në impiantet e trajtimit, kryhet në vende me sipërfaqe të papërshkueshme nga uji dhe me çati mbrojtëse nga kushtet e motit ose në kontejnerë të përshtatshëm.

Pjesa B: Riciklimi

3. Proceset e riciklimit projektohen në atë mënyrë që lejon të arrihen minimalisht nivelet e mëposhtme të efikasitetit të riciklimit:

a) riciklimi i 65% të peshës mesatare të baterive dhe akumulatorëve me acid plumbi, përfshirë riciklimin e përmbajtjes së plumbit në shkallën më të lartë që është teknikisht e mundur dhe që shmang kostot e tepërta;

b) riciklimin e 75% të peshës mesatare të baterive dhe akumulatorëve me nikel-kadmium, përfshirë riciklimin e përmbajtjes së kadmiumit në shkallën më të lartë që është teknikisht e mundshme dhe që shmang kostot e tepërta; dhe

c) riciklimin e 50% të peshës mesatare të mbetjeve të tjera të baterive dhe akumulatorëve.

VENDIM

Nr. 925, datë 19.12.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES, PËR PËRBALLIMIN E DETYRIMEVE KONTRAKTORE NDAJ “UNIVERS-ALB” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 07340 “Mbështetja shëndetësore”, në artikullin 602 “Mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekësh, për përballimin e detyrimeve kontraktore të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar ndaj “Univers-Alb” sh.a.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 67, datë 27.11.2012

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHITESË NGA BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43 shkronja “e” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 pikat 1 dhe 3, nenit 24 pika 1 shkronja “ç” të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 3 pika 2 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar, me propozim të departamentit të mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratim paraparak për kryerjen nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

a) shërbim i kasave të sigurimit.



2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., pas kryerjes së ndryshimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet departamenti i mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet departamenti i marrëdhënieve me jashtë, integritimit europian dhe komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM

Nr. 157, datë 30.11.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIFONIK PRIVAT ME PËRSËRITËS “RADIO WORLD FAMILY”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat me përsëritës “Radio World Family”, në fushën e transmetimeve radiofonike private me përsëritës.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet nga data 15.10.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr. 158, datë 30.11.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO IME”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Ime”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 9.11.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr. 159, datë 30.11.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO KLAN”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Klan”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 9.11.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 27.12.2012
Doli nga shtypi më 27.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 34 lekë